



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, al. 1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, dhe nenit 19, al.1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2004 merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E PÛRKOHSHËM TË LOKACIONIT PËR
TREGUN E DRUVE NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e përkohëshëm të lokacionit për Tregun e druve në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni, nga neni 1 i këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 831 Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe përafërsisht prej 1.0 ha..

Neni 3

Lokacioni i caktuar sipas këtij Vendimi ka karakterin e përkohëshëm, përkatësisht për periudhën prej 1 viti, duke llogaritur nga dita e miratimit të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 353-3380 DT. 07.12.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri